



**REPUBLICA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLËN E GJUHËVE TË HUAJA**  
**(GJIMNAZ GJUHËSOR)**

**FUSHA: GJUHË E HUAJ**

**LËNDA: GJERMANISHT**

**KODI: 3.3.11.Zgj.(f)**

**PROGRAMI I LËNDËS**  
**GJERMANISHT**  
**PËR KLASËN E 12-TË**

**Koordinatorë: Erifili Hashorva**

**Redaktore letrare: Vjola Grillo**

**Përgjegjëse sektori: Marita Hamza**

**TIRANË, NËNTOR 2010**

Programi i gjuhës gjermane si gjuhë e tretë (me zgjedhje) për klasën e 12-të të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja të nivelit fillestar gjuhësor është dokument zyrtar që synon të arrihet niveli **A2**.

Si të gjitha programet e tjera, edhe ky program mbështetet në orientimet e Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët dhe mundëson zhvillimin e pavarur të nxënësve, formimin intelektual e social-kulturor të tyre.

Njohja dhe formimi gjuhësor i nxënësve përbën synimin kryesor të këtij programi, duke i përgatitur për studime të mëtejshme me qëllim që t'i bëjnë ballë tregut të punës si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të (gjuhë me zgjedhje) për nivelin fillestar është konceptuar dhe përpiluar në mënyrë të tillë që, me anë të dijeve të përfuara gjatë procesit mësimor, nxënës/i,-ja të zhvillojë personalitetin e tij/saj, duke rritur besimin si përdorues i gjuhës, si dhe rrit ndjenjën e përgjegjësisë ndaj procesit të komunikimit në gjuhën e huaj.

## **1. SYNIMI I LËNDËS**

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të për nivelin fillestar, si gjuhë e tretë, synon: të hedhë bazat gjuhësore dhe, në përfundim të programit, nxënësit të arrijnë nivelin A2; të zhvillojë të katër aftësitë gjuhësore (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit) dhe bashkëbisedimin bazë gjuhësor e ndërkulturor të nxënësve.

## **2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM**

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të, niveli fillestar, ka si objektiv të zhvillojë aftësinë perceptuese në përthithjen e një informacioni bazë gjuhësor e kulturor, duke e ndërthurur këtë informacion me njohuritë e lëndëve të tjera, ku nxënës/i,-ja:

- Të ketë aftësi për të lidhur situatat gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- të reagojë ndaj ndryshimit të kulturave të të dyja gjuhëve;
- të ndërjegjësohet për kulturën e vendeve gjermanishtfolëse;
- të përdorë njohuritë gjuhësore e kulturore në kontekste të caktuara kuptimore;
- të ketë shkathtësi dhe saktësi në komunikimin me shkrim dhe me gojë.

Realizimi i këtyre objektivave është detyrim për përdoruesit e programit dhe për të gjithë nxënësit, që do të thotë se atyre u mundësohet nxënia e njohurive të përshkruara në objektiv.

## **3. OBJEKTIVA SIPAS STANDARDEVE**

Objektivat e programit të gjuhës gjermane të klasës së 12-të për nivelin fillestar përcaktohen me hollësi sipas aftësive dhe standardeve. Ato janë:

### **a) Objektivat sipas standardit në komunikim**

**Përshkrimi:** Nëpërmjet situatave të ndryshme, të përshtatshme për grupmoshën dhe nivelin gjuhësor, këta objektiva i mundësojnë nxënësit të përftojnë njohuri fillestare gjuhësore të

nevojshme për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm në një mjedis gjuhësor e kulturor gjermanishtfolës.

Kjo linjë pasuron dijet e përgjithshme të nxënësit dhe e përgatit atë emocionalisht për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën.

Standardi	Objektiva
<b>Komunikimi</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të vendosë një kontakt social bazë, duke përdorur formulat e mirësjelljes, përshëndetjet, urimet etj.;</li> <li>• të pyesë duke dhënë opinionin e tij;</li> <li>• të shprehë, me një gjuhë dhe strukturë të thjeshtë, ndjenja dëshira, simpati, frikë, keqardhje, gëzim, keqardhje, zemërim dhe dhimbje;</li> <li>• të shpjegojë një problem, duke vënë në dukje kushtet e realizimit;</li> <li>• të bëjë dallim mes objekteve, veçorive dalluese dhe interpretimit të tyre;</li> <li>• të kërkojë/të japë një informacion lidhur me situata dhe tema të njohura;</li> <li>• të falë/kërkojë falje, duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme;</li> <li>• të përshkruajë me detaje monumente të artit, personalitete, ngjarje me rëndësi historike (p.sh., kështjellat dhe monumentet kulturore të Gjermanisë etj.);</li> <li>• të trajtojë, bashkë me mësimin e gjuhës, çështje që lidhen me përdorimin e saj, si: treguesit e marrëdhënieve shoqërore, rregullat e mirësjelljes.</li> </ul>
Standardi	Objektiva
<b>Veprimtaritë e Komunikimit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë një gjuhë përshkruese të thjeshtë për të folur shkurt për objekte dhe sende që zotëron dhe i krahason ato;</li> <li>• të flasë për profesionet;</li> <li>• të organizojë një festë;</li> <li>• të formulojë një CV, një reklamë;</li> <li>• të zhvillojë një bisedë të ngadaltë dhe të artikuluar thjesht;</li> <li>• të japë informacion mbi kohën, vendndodhjen në hapësirë etj.;</li> <li>• të shprehë opinione pozitive/negative mbi një send a person;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë çfarë do dhe çfarë nuk do;</li> <li>• të bëjë një përshkrim të thjeshtë dhe të shkurtër të ngjarjeve dhe të veprimtarive;</li> <li>• të kuptojë udhëzime të thjeshta për t'u orientuar në rrugë ose për arritur në destinacion;</li> <li>• të nxjerrë pikat thelbësore të mesazheve e të lajmërimeve të shkurtra;</li> <li>• të gjejë kuptimin e fjalëve të panjohura nga një kontekst i thjeshtë dhe familjar;</li> <li>• të shkruajë një letër, <i>sms</i>, <i>e-mail</i> në internet;</li> <li>• të flasë për argëtimet (muzikën, festat, aktivitete të jetës së përditshme, sportin etj.);</li> <li>• të prezantojë një recetë kuzhine;</li> <li>• të përshkruajë vende turistike, objekte dhe persona që lidhen me mjedisin dhe me interesat e tij/saj.</li> </ul>
--	---

#### b) Objektiva sipas standardit në kulturë

**Përshkrimi:** Objektivat e standardeve në këtë fushë parashikojnë një shkallë më të lartë të ndërgjegjësimit kulturor, duke vënë theksin në ndërveprimin gjuhësor dhe kulturor në fusha të interesit dhe të prioritetit imediat, siç janë: ato të familjes, të formimit, të tregut etj.

Standardi	Objektiva
<b>Kultura</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dijë t'i drejtohet dikujt sipas hierarkisë për probleme të ndryshme social-kulturore që lidhen me prioritetin imediat të fushës së tij të interesit;</li> <li>• të ndërmarrë, sipas nevojave të ndryshme të tij/saj, veprimtari komunikative ndërvepruese, si: biseda, korrespondenca me qëllim këmbimet social-kulturore në favor të prioritetit imediat dhe fushës së tij/saj të interesit;</li> <li>• të emërtojë të dhënat e përgjithshme gjeografike të vendeve gjermanishtfolëse;</li> <li>• të përdorë saktë në ligjërim, si përdorues elementar, intonacionin dhe gjestet, si elemente social-kulturore të rëndësishme në ndërveprimin gjuhësor;</li> <li>• të emërtojë kalendarin festiv, duke e krahasuar me atë kombëtar;</li> <li>• të thellojë njohuritë e tij/saj mbi kulturën, monumentet e artit, personalitetet dhe ngjarjet më të</li> </ul>

	<p>rëndësishme të vendeve ku flitet gjermanisht;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të zgjerojë dijet e tij mbi fushën e modës dhe të artit në vendet gjermanishtfolëse.</li> </ul>
--	---

**c) Objektiva sipas standardit në formimin gjuhësor**

**Përshkrimi:** Kjo linjë aftëson nxënës/in,-en të prodhojë elemente gjuhësore, që i përkasin nivelit A2. Të gjithë nxënësit arrijnë një formim gjuhësor që lejon një komunikim bazë, njohjen e strukturave gjuhësore, duke siguruar nivelin e nxënës/it,-es përdorues fillestar i gjuhës. Nxënës/i,-ja, në këtë nivel, mund të kuptojë dhe të përdorë shprehje të njohura dhe të përditshme, si dhe të reagojë në situata të lidhura me fushat e tij të interesit.

<b>Standardi</b>	<b>Objektiva</b>
<b>Elemente gramatikore</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të zotërojë një repertor të gjuhës fillestare (strukturë dhe leksik), që i lejon të përballojë situata të ndryshme të ligjërimit me shkrim dhe me gojë;</li> <li>të zotërojë skema të thjeshta e të sakta për të shprehur mendimin, idetë, në ligjërimin me shkrim e me gojë;</li> <li>të përdorë drejt kohët e foljeve në fjali (e tashme, e shkuar, e ardhme, e kryer, e pakryer);</li> <li>të përdorë drejt, në varësi të situatave, mënyrat e foljes në fjalinë e përbërë, (dëftoren, urdhëroren, etj.);</li> <li>të përdorë drejt përemrat vetorë në rasën dhanore e kallëzore;</li> <li>të shprehet në ligjëratë të drejtë, duke realizuar saktë përshtatjen morfo-sintaksore;</li> <li>të zotërojë fjalinë e thjeshtë dhe rendin e fjalëve në fjali;</li> <li>të përdorë drejt: emrat e përbërë, lakimin e emrave, foljet vetvetore etj.</li> </ul>

#### 4: OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektivat
<b>Të dëgjuarit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja, aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kapë thelbin në mesazhe të shkurtra e të thjeshta, si dhe në njoftime shkollore;</li> <li>• të kuptojë frazat dhe fjalët që lidhen me fushat e interesit të tij/saj të çastit;</li> <li>• të ndjekë biseda të përditshme të artikuluara qartë që i drejtohen atij/asaj;</li> <li>• të kuptojë çështjet kryesore në buletine lajmesh.</li> </ul>
<b>Të folurit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja, aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përfundojë me bashkëfolësin një bisedë për një temë të njohur që paraqet interes.</li> <li>• të shkëmbejë pikëpamje (të shprehë mendime) vetjake në një diskutim mes miqsh;</li> <li>• të sqarojë shkurt planet dhe qëllimet e tij/saj;</li> <li>• të shprehë ndjenja, të tilla si: habia, gëzimi, trishtimi, kureshtja etj.;</li> <li>• të transmetojë një informacion të domosdoshëm, duke theksuar pikën më të rëndësishme sipas mendimit të tij;</li> <li>• të zotërojë një fjalor të mjaftueshëm për t'u shprehur, hera - herës duke e perifrastuar, për temat që i takojnë jetës së përditshme.</li> </ul>
<b>Të lexuarit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja, aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë artikuj ose intervista në gazeta e revista ku bëhet fjalë për tema dhe ngjarje aktuale, duke kuptuar thelbin e informacionit;</li> <li>• të kuptojë informacionin apo faktet e kërkuara (p.sh., kur dhe ku është kryer diçka), duke u hedhur një sy të shpejtë teksteve të shkurtra;</li> <li>• të kuptojë mesazhe të thjeshta dhe letra standarde rreth udhëtimeve, shërbimeve postare, blerjeve etj.;</li> <li>• të kuptojë subjektin e një tregimi të strukturuar mirë, duke dalluar ngjarjet dhe episodet më të rëndësishme në të.</li> </ul>

<p><b>Të shkruarit</b></p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja, aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë tekste të thjeshta për tema të ndryshme, duke lidhur në seri elementet e rëndësishme;</li> <li>• të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar;</li> <li>• të shkruajë përmbajtjen e një libri për fëmijë, të një filmi etj.;</li> <li>• të hartojë letra, kartolina, sms dhe tekste të shkurtra me një gjuhë të kuptueshme dhe të qartë për veprimtaritë e përditshme.</li> </ul>
----------------------------	--

## 5. KËRKESA TË GJUHËS GJERMANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore, në përgjithësi, dhe të katër aftësive (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit), në veçanti.

Konceptet dhe njohuritë e tjera gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, që lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës gjermane e të trajtuara në lëndët e tjera, si:

**Gjeografia**, e cila me njohuritë e saj pajis nxënësit me informacione për vendet gjermanishtfolëse (Gjermani, Austri, Zvicër), vendet turistike, peizazhin, veprat e artit dhe i afron ata më tepër me kulturën e këtyre vendeve. Nxënësit do të mësojnë për klimën, relievin, lumenjtë etj. të këtyre vendeve.

**Sociologjia**, e cila i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë zakonet, kulturën, traditën e këtyre vendeve. Ata do të ndërgjegjësohen më shumë për shumëllojshmërinë e kësaj bote dhe do të bëhen më të ndërgjegjshëm, më tolerantë, duke kuptuar dhe thelbin e mentalitetit të këtyre vendeve.

**Historia**, e cila nëpërmjet informacioneve të saj i afron nxënësit më tepër me historinë gjermane. Ngjarjet e rëndësishme historike që shënuan fatin e shumë vendeve në botë dhe të vetë Gjermanisë do t'i ndihmojnë nxënësit të formojnë mendimin e tyre për këto ngjarje, duke kultivuar tek ata një mendim kritik.

**Edukimi mjedisor:** Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

**Edukimi kulturor dhe etik:** Dy lëndët kryesore, gjeografia dhe historia, do të ndikojnë në formimin kulturor dhe etik të nxënësve nëpërmjet njohurive të trajtuara prej tyre. Zakonet, kultura dhe traditat e këtyre vendeve do të kultivojnë te nxënësit aftësinë për të kuptuar më mirë njerëzit, kulturën dhe mentalitetin e këtyre vendeve.

**Edukimi për të drejtat e njeriut:** Njohja e kulturave të vendeve gjermanishtfolëse realizohet e lidhur ngushtë me temat e barazisë sociale, të mosdiskriminimit social, të respektit reciprok etj., duke i bërë nxënësit më tolerantë me njëri-tjetrin.

## 6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të është dokument zyrtar, si pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës gjermane dhe duhet të zbatohet nga mësues, autorë të teksteve etj.

Siç është përmendur dhe më lart, dokumentet e tjera kryesore janë:

- Kuadri i Përbashkët European i Referencave për Gjuhët.
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar.

Programi i avancuar i klasës së 12-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies/mësimnxënies së gjuhës gjermane në nivelin A2. Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Është shumë e rëndësishme njohja dhe përvetësimi i programeve lëndore të lëndës së gjuhës gjermane për klasën pasardhëse.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxëniet dhe të gjitha programet lëndore të së njëjtës klasë.

### Objektivat

Objektivat e këtij programi, me anë të të cilit nxënësit thellojnë njohuritë në mësimin e gjuhës gjermane, janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë që nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë atë që përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

### Orët mësimore

Në programin e lëndës së gjuhës gjermane, afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për thellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit shkollor dhe në fund të tij).

### Shpërndarja e orëve

Ky program parashikon shtrirjen e mësimin të gjuhës gjermane në gjithë vitin shkollor dhe do të realizohet në 102 orë mësimore, me një frekuencë prej 3 orësh në javë, d.m.th.:

$$34 \text{ javë} \times 3 \text{ orë} = 102 \text{ orë vjetore.}$$

Shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

**Komunikimi dhe formimi kulturor zë 71 orë**, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 50 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70% e tyre, që përbëjnë 35 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 15 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive. Me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni). Aktet dhe funksionet e komunikimit do të zënë 21 orë (70% e tyre, që përbëjnë 15 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 6 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës.



Ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

**Formimi gjuhësor zë 31 orë.** Janë kryesisht orë, në të cilat mësuesi shtjellon në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 22 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 9 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin).

Përmbajtja mësimore e lëndës së gjuhës gjermane për klasën e 12-të të shkollave të mesme të gjuhëve të huaja realizohet duke synuar nivelin A2.

Këtu duhet mbajtur parasysh, sigurisht, edhe përdorimi i gjuhës nga nxënës/i,-ja, pra përvetësimi i aftësisë pragmatike që do t'i lejojë atij/asaj ta përdorë gjuhën sipas qëllimeve të caktuara. Formimi gjuhësor, gjithashtu, duhet të privilegjojë aftësitë komunikative të gjuhës, larg formave të mësimin tradicional të gramatikës.

### **Përpunimi i njohurive**

Përpunimi i njohurive përmban:

- Testimin e njohurive të avancuara.
- Integrimin e njohurive të thelluara të lëndës me njohuritë e marra.
- Integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme.).
- Përsëritjen vjetore.
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë përpunimit të njohurive të thelluara, duhet t'u kushtohet kohë e posaçme:

- Kultivimit të aftësive të përgjithshme, si të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore, të të menduarit kritik dhe krijues.
- Kultivimit të aftësive të posaçme lëndore, si: komunikimi gojor, shkrimi riprodhues e krijues, kuptimi i teksteve me vështirësi dhe gjatësi mesatare, kalimi nga kuptimi thelbësor tek ai më i detajuar, kuptimi me gojë dhe ndërveprimi bisedor etj.
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social.

### **Metoda dhe strategji të mësimdhënies/mësimnxënies**

#### **Të dëgjuarit**

- Të kuptojë përmbajtjen dhe rendin e ngjarjeve në një tekst;
- të kuptojë dhe të gjejë informacione të sakta në një tekst të shkurtër dëgjimi;
- të kuptojë informacionet, udhëzimet të cilat i shërbejnë si impulse në situata të caktuara të jetës së përditshme;
- të kuptojë informacionin në detaje në njoftime të shkurtra.

### **Të folurit**

- Të shkëmbejë informacione në situata të parashikuara të jetës së përditshme;
- të marrë dhe të japë informacione për ngjarje të së tashmes, të së shkuarës dhe të së ardhmes;
- të shkëmbejë informacione dhe ide në lidhje me tema të interesit vetjak në situata bashkëbisedimi të pandërlikuara.

### **Të lexuarit**

- Të lexojë dhe të kuptojë njoftimet kryesore të tabelave dhe parullave publike;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura në kontekst;
- të kuptojë tekste të gjata për tema të njohura të pasura me foto.

### **Të shkruarit**

- Të hartojë tekste të shkurtra dhe të thjeshta në lidhje me një kontekst të caktuar të aspekteve të jetës së përditshme, si mjedisi;
- të shkruajë tekste të thjeshta me mendimet dhe argumentet personale;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat dygjymtyrëshe dhe lidhëzat e nënrenditura;
- të reagojë ndaj teksteve, duke dhënë mendimin e tij personal në lidhje me përmbajtjen dhe tematikën.

## **C. Parime për zbatimin e programit**

### **Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes**

Nxënës/i,-ja duhet të jetë në qendër të procesit mësimor dhe të gëzojë të drejta të plota pjesëmarrjeje, duke shprehur përvojën e tij/saj jetësore. Kjo do të realizohet:

- Duke përzgjedhur tema, lloje të teksteve dhe forma sociale të orientuara sipas interesave dhe nevojave të moshës së klasës së 12-të, duke pasur parasysh nivelin dhe rezultatet e tyre.
- Duke përdorur strategji që e nxisin nxënës/in,-en të veprojnë me gjuhën.
- Duke e përfshirë nxënës/in,-en në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e dijeve të përftuara.

### **Organizimi i klasës**

Duke dalë nga forma standarde, tashmë e vjetruar e mësimdhënies frontale dhe duke e vënë nxënësin në qendër të vëmendjes, mësuesi do të bëhet organizues, furnizues dhe orientues për nxënësit duke i bërë ata pjesë aktive në mësim. Ai do t'i ndihmojë nxënësit për një të mësuar të qëndrueshëm. Mësuesi ka më tepër rol planifikues, sesa burim i të gjitha njohurive në klasë.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe atë të situatave sa më afër jetës reale etj.

Mësuesi është i lirë dhe i pavarur në përdorimin e metodave dhe të materialeve mësimore që mbështesin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore si të nxënësve, ashtu dhe të tij (mësuesit).

Puna në grupe, me partnerë, motivon nxënësit të cilët mësojnë më tepër nga shkëmbimi i informacionit me njëri-tjetrin. Mësuesi ideon orën e mësimit dhe nxënësit bëhen aktivë nëpërmjet formave bashkëvepruese të mësimdhënies, të cilat zgjidhen nga mësuesi. Në nivelin A2 duhet të përpiqemi që nxënësi/i,-ja të punojë në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi.

### **Të mësuarit bashkëveprues**

Format e reja të punës, p.sh., në grupe, me partnerë, i bën nxënësit më bashkëveprues, më tolerantë duke i aftësuar të përdorin forma demokratike në bashkëbisedim. Duke ndarë përgjegjësitë dhe punën, nxënësit mësojnë të shoqërohen dhe të punojnë me të tjerë.

Nxënësit aftësohen drejt pavarësisë në rritje në përfitimin gjuhësor gjatë mësimit të gjermanishtes, e mundësuar kjo nëpërmjet aktiviteteve përkatëse të të mësuarit dhe formave të larmishme sociale.

### **Përdorimi i gjuhës në klasë**

Në nivelin gjuhësor A2, nxënësi është më i formuar nga ana gjuhësore e kulturore dhe është i gatshëm të përdorë gjuhën gjermane në situata të thjeshta komunikimi për veprimtari që lidhen me kontekstin e përditshëm.

### **Të mësuarit e gramatikës**

Gjuha gjermane ka si element të rëndësishëm dhe strukturat gramatikore, të cilat nuk duhet të jepen të izoluara, si qëllim në vetvete, por në lidhje me aftësitë gjuhësore dhe me përpunimin e temave dhe të kompetencave leksikore.

Gramatika duhet të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive, me qëllim që të nxiten nxënësit drejt një procesi analitik dhe nga mendimi kritik. Kjo do të thotë që nxënësi duhet të dalë vetë nëpërmjet shembujve të shumtë dhe të larmishëm të rregullit gramatikor. Duhet të hiqet dorë nga dhënia paraprake nga mësuesit e rregullave dhe tabelave shabllo.

### **Korrigjimi i gabimeve**

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të pasqyron më së miri mënyrën e korrigjimit të gabimeve. Niveli A2 parashikon që nxënësit të aftësohen të vetëkorrigjohen ose të korrigjojnë njëri-tjetrin dhe të mësojnë prej gabimeve që ata bëjnë. Shpesh, mësues/i,-ja shënon gabimet e përsëritura dhe, kur është e nevojshme, edhe i korrigjon ato, duke i qartësuar dhe duke përdorur format e sakta gjuhësore në strukturë për të formuar te nxënësi shprehje për strukturën e dhënë.

## Puna e diferencuar

Me qëllim që metodat e mësimdhënies/mësimnxënies, parimet dhe strategjitë, mbi të cilat realizohen këto metoda, të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësues/i,-ja planifikon punën e diferencuar me nxënës/it,-et. Kështu ai mund të krijojë grupe të ndryshme me nxënës/-e të përparuar/-a dhe të prapambetur/-a, duke caktuar detyra në grup për të mos i vënë në vështirësi ata/ato dhe për t'i inkurajuar të zgjidhin ato detyra që munden.

Mësuesi/-ja mund t'u japë gradualisht detyra plus për të siguruar një nivelim të tyre me të tjerët, por duke bërë kujdes dhe duke gjetur detyra motivuese e tërheqëse që të mos rrisë vështirësitë e tyre.

Një motivim i mirë për thellimin e njohurive të gjermanishtes, konkretisht për nxënësit e përparuar, është puna e veprimtarive shtesë, si: përzgjedhje e materialeve autentike, krijime me shkrim në kuadër konkursesh, recitime ose vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj etj. Mësuesi mund të përdorë punën e këtyre nxënësve për të realizuar bashkë me ta një aspekt shumë të rëndësishëm të metodologjisë së zbatimit të programit, si integrimi lëndor, ku nxënës/it,-et e përparuar/-a mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

Si rekomandim, më poshtë jepen disa forma didaktike që mund të përdorë mësuesi për tërheqjen e të gjithë nxënësve në procesin mësimor:

- Të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve;
- të ndjekë klasën në çdo hap, brenda dhe jashtë saj;
- të ndajë përgjegjësitë, atje dhe atëherë kur duhet, për çështje vendimi, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj.;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej nxënësve vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive;
- të shmangë çdo gjë që nuk i përshtatet moshës së nxënësve;
- të zgjedhë materiale për mësim në përputhje me kërkesat dhe me standardet e programit mësimor;
- të përpiqet ta mënjanojë diçka, nëse nuk ecën në klasë, dhe të përdorë punën në grup ose për individë të veçantë, punën individuale;
- të përdorë ushtrime që kërkojnë pjesëmarrje aktive, duke nxitur edhe nxënësit me dije jo të plota të përfshihen në to;
- të shmangë ushtrime që i vënë këta nxënës në vështirësi dhe i zënë ngushtë;
- të motivojë nxënës/in,-en edhe për një detyrë fare të vogël që ka bërë, me qëllim që të rritet dëshira dhe përgjegjësia për mësimin e gjuhës së huaj;
- të mos paragjykojë nxënësit, por përkundrazi t'u japë ushtrime që kërkojnë vëmendje dhe punë.

## 7. VLERËSIMI

Matja e përparimit dhe e arritjeve të nxënësve në gjuhën e huaj, duhet të jetë objektiv dhe i matshëm.

Të vlerësosh nxënës/in,-en nuk është e lehtë dhe kjo mund të bëhet në mënyra nga më të ndryshme.

### *Vlerësim diagnostikues*

Mësues/i,-ja do të mund të realizojë këtë vlerësim duke njohur dhe duke vlerësuar arritjet dhe mangësitë, duke i dëgjuar nxënësit të flasin dhe lexojnë, duke vëzhguar të shkruarit e tyre dhe duke analizuar aftësitë dhe gabimet e nxënësve përmes përdorimit të analizës së rezultateve dhe evidencave të rregullta. Ky lloj vlerësimi:

- Jep informacion për efektshmërinë e të nxënësit;
- ndihmon në gjetjen e mënyrës së veprimit në etapën e dytë të të mësuarit;
- ndihmon të gjenden arsyet dhe shkaqet e mospërvetësimit të koncepteve.

### *Vlerësim formues*

Nëpërmjet këtij vlerësimi synohet të theksohet ajo çfarë ka arritur nxënësi gjatë procesit të formimit të njohurive. Ky vlerësim kryhet në fillim: për vendosjen e objektivave në procesin mësimor, gjatë vitit: për të vlerësuar ecurinë e njohurive të fituara, për përmirësim, si dhe në fund të vitit: për të parë se çfarë është arritur.

Më poshtë sugjerohen disa veprimtari ose kërkesa për vetëvlerësimin formues:

- Pas një veprimtarie, të bëhet një pushim dhe të bëhet pyetja: “Çfarë keni mësuar?”;
- t’i bëhet e ditur nxënës/it,-es që gjithnjë duhet të bëjë një bilanc të gjërave të mësuara dhe atyre të përvetësuara;
- në një situatë me rezultat të lartë, të pyeten nxënësit “Çfarë bëtë për të arritur këtë rezultat?” dhe të nxiten ata të shkëmbejnë përvojën e tyre mbi këtë temë;
- pas një krijimi me shkrim, t’i kërkohet nxënës/it,-es të tregojë çdo gjë, për të cilën është i sigurt në tekstin e tij (p.sh., duke nënvizuar).

### *Vlerësim përmbledhës*

Ky vlerësim bëhet në fund të një numri temash, njësisish, detyrash e kapitujsh, ose në fund të një periudhe të caktuar kohore.

### *Vlerësim motivues*

Ky vlerësim ka për qëllim të nxisë interesin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuar.

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë objektiv dhe i matshëm.

Do të inkurajohen nxënësit të njohin procedurat e vlerësimit si mundësi për *vetëvlerësim*. Nxënësit do të nxiten të zhvillojnë të menduarit e pavarur dhe vetëdijen për aftësinë e tyre për përmirësime përmes kuptimit të hollësishëm të proceseve të vlerësimit.

Nxënësi vlerëson veten nëpërmjet një pyetësi mbi atë “*se çfarë di të bëjë ai?*”.

Vetëvlerësimi është një formë e re, por mjaft e përhapur tashmë në botën arsimore. Ai është pjesë e të mësuarit të pavarur dhe konsiderohet mjaft i nevojshëm si nga nxënësit, ashtu dhe nga mësuesit. Është detyrë e çdo mësuesi të shpjegojë dhe të njohë nxënësit me përmbajtjen e vetëvlerësimit, përdorimi i të cilës do të sjellë ndërgjegjësim të mëtejshëm të problemeve të të mësuarit.

Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli Europian i Gjuhëve (PEGj) që, me anë të tri pjesëve të tij (Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë Gjuhësore dhe Dosjes), nxit nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe duke dokumentuar arritjet e tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

PEGj-i është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGj-i e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste, dhe të vazhdojë t’i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGj-i e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGj-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Europë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas, mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentim përfundimtar.
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit/-es.
- Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij, duke përdorur edhe gjuhën amtare.
- Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin, që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi.

Gjithashtu, mund t’i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetëkorrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta ose ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar.

*Bashkëbisedimi* i lirshëm dhe i hapur me mësuesin është elementi më i rëndësishëm dhe nuk është detyrim për mësuesin vënia e notave çdo orë mësimore. Ai duhet të vendosë herë pas here nota, por këto nuk duhet të jenë objektivi i vetëm i punës gjatë orës mësimore.

*Vlerësimi me shkrim* shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të realizuara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disaminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësit, deri tek testet njëorëshe, teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e punës me shkrim nga nxënësit është dhe *provimi përfundimtar*. Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij/saj përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësues/i,-ja është në rolin e atij/asaj që drejton, që rekomandon dhe që orienton.